

351.74 - 051

Armend Halimi<sup>1</sup>

Fisnik Sadiku<sup>2</sup>

## **FUNKSIONET E POLICISË MBI BAZËN E KRITEREVE PROFESIONALE**

## **ФУНКЦИИТЕ НА ПОЛИЦИЈАТА ВРЗ ОСНОВА НА ПРОФЕСИОНАЛНИТЕ КРИТЕРИУМИ**

## **THE POLICE FUNCTIONS BASED ON THE PROFESSIONAL CRITERIA**

### **Abstract**

In this paper, we would like to present the criteria or qualities that Police should possess, specifically the Kosovo Police in the exercise of its function as an institution with a relatively new history. However, regardless of the place, the police represent an important institution for the social security, and as complex in the exercise of its functions. Police as an institution, not only law enforcement but also its defense, among its many functions, has the most important and the most sensitive. In this regard, it is known that one of its tasks is to provide security and protect the lives of citizens, goods and the prevention of crime. From all this, I consider that it is fair to say that on the basis of the police mission comes a challenge, it is law enforcement and its defense. This means a commitment to exercise its function; on the other hand care should be taken towards freedom and human rights. Therefore, police work requires a careful and successful work in function of its mission. While its function to be consistent with professional standards and its work to be valued, the police should take into account the law as a rule, along with the recommended values. With this purpose, in this paper we will talk on the functions of the police in democratic societies, values that should possess, and

---

<sup>1</sup> Autori është magjistër i shkencave të sigurisë, diplomuar pranë Universitetit të Evropës Juglindore, Tetovë, njëherit ligjërues në Kolegjin Universitar “FAMA”, Prishtinë.

<sup>2</sup> Fisnik Sadiku është magjistër i shkencave të sigurisë, diplomuar pranë Universitetit të Evropës Juglindore, Tetovë.

avoidance of actions that undermine its image, with special emphasis on moderation that should show in the use of force in the exercise of powers, so that the force to be used only on the basis of necessity and proportionality.

### **1. Policia në shtetin e së drejtës**

Në shtetin demokratik dhe së drejtës, policia krijohet për t'i shërbyer qytetarit dhe interesave të përgjithshme të shoqërisë. Në këtë drejtim, gjithë hapat apo veprimtaria e saj duhet bazuar në legjislacion, njëherësh duke qenë në përputhje me të dhe standardet ndërkombëtare të harmonizuar në legjislacionin vendor.<sup>3</sup>

### **2. Funkcionet e policisë në shtetin e së drejtës**

Policia është pjesë e sistemit të drejtësisë penale të vendit. Roli i policisë brenda këtij sistemi konsideroj se është i pazëvendësueshëm, ngase siç thuhet në shkencën procedurale, "policia gjendet në vijën e parë të frontit".<sup>4</sup>

Në këtë drejtim, policia është shumë e përafërt me institucionet e judikaturës, kur të merret parasysh funksionimi dhe aktiviteti, andaj llogaritet në mesin e institucioneve të judikaturës penale.<sup>5</sup>

Policia në shumë shtete është institucion publik-civil dhe i organizuar në bazë të ligjit. Kështu, policia është një institucion tradicional i njohur për mbrojtjen e rendit shoqëror në të gjitha tipat historike shoqërore dhe në të gjitha vendet në botë.

Në të gjitha vendet, duke llogaritur edhe shoqëritë bashkëkohore, policia, përveç nga aspekti formal, i ka të njëjtat përcaktime shoqërore dhe kryen përafërsisht të njëjtat funksione dhe detyra.

Përgjithësisht, policia është organ që ka për detyrë t'i shërbejë shoqërisë, çka lenë të kuptohet se pavarësisht vendit objektivat e saj janë të njëjta, por gjithsesi misioni i saj varet edhe nga rregullimi i sistemit politik të vendit të caktuar. Kështu, në sistemet totalitare policia shërben vetëm për interesin e pushtetit, ndërsa për kundërshtarët e tij, respektivisht shoqërinë civile ajo ushtron shtypje dhe presion me qëllim të mbrojtjes së shtresës sunduese sipas përcaktimeve të saj.

Ndërsa, në shtetet demokratike që thirren në shtetin e së drejtës, objektivat të cilat njihen si funksione apo autorizime të policisë kanë

<sup>3</sup> Halimi, Armend, Roli i policisë në luftimin e kriminalitetit në Kosovë, Prishtinë, 2015, f. 53.

<sup>4</sup> Sahiti, Ejup, E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 2005, f. 189.

<sup>5</sup> Latifi, Vesel, Taktika kriminalistike, Prishtinë, 2001, f. 26.

krejtësisht karakter tjetër, si;

- respektimi dhe mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të sanksionuar si me legjislacionin vendor ashtu edhe me atë ndërkombëtar;

- mbrojtja e qetësisë dhe sigurisë publike, dhe e rendit juridik;
- parandalimi dhe luftimi i kriminalitetit dhe zbulimi i tij;
- garantimi i lirisë së lëvizjes;
- kontrollimi i kufijve shtetërorë;
- asistenca, ndihma apo dhënia e shërbimeve ndaj shoqërisë, etj.<sup>6</sup>

Në bazë të këtyre funksioneve që paraqesin vlerat më të larta të shoqërisë, policia në shtetin demokratik ka për detyrë t'i mbrojë ato.

Me qëllim që të jetë e mundur ushtrimi i funksioneve të sipërpërmendura, dhe me qëllim që forcën e përdorur gjatë ushtrimit të funksioneve në fjalë ta bëjë konform autorizimeve ligjore, në vijim do të paraqes cilësitë që duhet të posedojë ajo për të shpresuar në suksesin e saj, dhe kujdesin që duhet të ketë përballë lirive dhe të drejtave të njeriut gjatë ushtrimit të fushë-veprimtarisë policore.

### 3. Cilësitë dhe kriteret të cilat duhet posedojë policia e mirë

*“Të këshillosh të tjerët për të mirë,  
ndërsa nuk i përmbahesh vet asaj, do të shihet kontrast  
sikurse nga një vazo  
lulesh të dalin predha të maskuara si lule”.*

*(Armend Halimi)*

Duke marrë për bazë autorizimet e policisë që i njeh Kushtetua dhe e obligon ligji, vërehen funksionet apo misioni i shenjt që kryen organi i policisë. Se cili shtet që pretendon të ndërtojë sistem të mirëfilltë demokratik, këtë synim mundohet ta arrij e jetësojë përmes organeve që i ngarkon për këtë qëllim në këtë rast siç është policia.

Për deri sa është misioni i tyre i shenjtë, e respektivisht i policisë që ka të bëjë me parandalimin e dukurive negative e të dëmshme për qytetarin dhe luftimin e kriminalitetit, është logjikisht kërkesë që personat që kanë për detyrë këtë mision të jenë vetë larg shprehive, gjesteve, e çdo veprimi anormal që do shihej si kontrast mes personalitetit të tyre dhe misionit që kanë.

<sup>6</sup> Vepra, e cituar në fusnotën 3.

Si rrjedhojë, me qëllim të elaborimit më të kuptueshëm mes përputhshmërisë që duhet të kenë personat me mision e tyre të shenjt, jam munduar të paraqes me një stil afarizmi, sikur personi të sillej në realitet ndryshe nga ajo që i thërret të tjerët për tu vepruar, pra për t'u distancuar nga dukurit negative, ngjanë në "të këshillosh të tjerët për të mire, ndërsa nuk i përmbahesh vet asaj, do të shihet kontrast sikurse nga një vazo lulesh të dalin predha të maskuara si lule".<sup>7</sup>

Nga e gjithë kjo, konsideroj se duhet pasur të qartë që institucioni i policisë të ketë në përbërje të saj individë me cilësi dhe virtyte të larta njerëzore e të çmuara nga shoqëria konform vlerave civilizuese.

Prandaj, me qëllim që të krijohet një polici efikase apo e aftë ajo duhet të ketë personel që kanë vizion të gjerë të shoqërisë ku shërben dhe që sjellja e tyre të jetë konform detyrave që kanë për obligim të kryejnë.

Për një polici efikase dhe përparimtare në aspektin e zhvillimit cilësor, përveç aspektit moral apo etik, është kusht edhe aftësia e tyre e përgjithshme, respektivisht përgatitja profesionale apo njohurit mbi fushat e policisë. Thënë më drejtë, personat që i nënshtrohen rekrutimit për pjesëtarë të policisë minimum duhet të kenë njohuri mbi çështjet sociale, kulturore, pa harruar nevojën e njohurisë së fushës policore, gjë që nuk duhet parë këtë si diskriminim ndaj të tjerëve, por këto janë si parakusht për një polici të mirëfilltë e të përgatitur për të kryer detyrat ashtu siç kërkohet.

Andaj, personeli policor, në çdo nivel, duhet të rekrutohet mbi bazën e kualifikimit dhe eksperiencës personale, të cilat duhet të jenë në përputhje me objektivat e policisë.

Ndër cilësitë më vendimtare për një polici efikase, në teorinë mbi policinë theksohen:<sup>8</sup>

-Mendja e shëndoshë e policit; vigjilenca e policit; njohja e punës nga ana e policit; stërvitja e mirë praktike e policit; inteligjenca e policit; përgjegjësia në punë dhe besnikëria e policit; pamja e jashtme e policit.

Mendja e shëndoshë e policit: Shëndeti i mirë në përgjithësi, nënkupton funksionimin e organizmit normal si në aspektin fizik dhe psikik të njeriut. Nuk mund të thuhet se shëndeti është në nivel të kënaqshëm, nëse njëri aspekt nuk funksionon.

<sup>7</sup> Halimi, Armend, Roli i Policisë në luftimin e kriminalitetit në Kosovë, Prishtinë, 2015, f. 91.

<sup>8</sup> George M. Pugh, The Good Police Officer, Roles, and Concepts, Izbor članka iz stanih časopisa, Zagreb, 1987, nr 1-2, f. 6.

Prandaj, mendoj se në punën e policisë nuk mjafton të ketë vetëm zhvillim fizik, e që aspekti i shëndetit psikik të mos jetë i zhvilluar në atë masë sa polici të jetë i paaftë të kuptoj detyrën që i është ngarkuar e që atë detyrë të mos arrij me realizuar mbi aftësinë e logjikës apo “mendjes së shëndoshë” me një fjalë të jetë i gjindshëm në raste edhe të rënda.

Sigurisht, që mendja e shëndoshë nuk mund të paramendohet edhe pa cilësitë normale që e karakterizojnë të themi kushtimisht një personalitet të mirë. Cilësitë e personalitetit të mirë janë: karakteri i fortë, temperament jonxitues, stabiliteti emocional etj.

“Pjesëtarët e policisë, përveç shëndetit fizik, duhet të posedojnë një nivel të caktuar të inteligjencës, stabilitetit emocional, një temperament të rëndomtë etj. Kjo cilësi që kërkohet nga pjesëtarët e policisë, qëllim kryesor ka që sistemi policor i një vendi, si organ shtetëror në një fushëveprim më specifik sesa organet e tjera shtetërore (duke llogaritur rrezikun e mundshëm gjatë punës), të mos ketë në radhët e veta punonjës agresiv dhe aq më pak jo me të meta në aspektin psikik”.<sup>9</sup>

Syçeltësia e policit: Syçeltësia është një tjetër cilësi që duhet të ketë polici i mirë. Syçeltësinë ndryshe duhet kuptuar si shkathësi të policit për të qenë vigjilent ndaj çdo rasti që ka nevojë për intervenim dhe në çdo moment gjatë dhe pas detyrës. Me një fjalë kjo cilësi do të thotë kujdes ndaj situatave që duhet vepruar, dhe që gjatë veprimit të dijë njëkohësisht logjikshëm se a po vepron konform autorizimeve ligjore.

Syçeltësia e policit duhet të manifestohet sidomos gjatë përdorimit të forcës dhe të mjeteve të dhunës, gjithnjë duke respektuar dispozitat ligjore, por edhe dinjitetin njerëzor të qytetarëve.

“Syçeltësia e policit si cilësi duhet ta shquajë policin dhe të jetë aktive gjatë gjithë kohës sa është pjesëtarë i shërbimit policor. Pavarësisht nëse gjendet në uniformë ose në veshje civile, polici duhet të jetë i vëmendshëm që veprimet që ndërmerr, të jenë nën kontrollin e plotë të vetëdijes dhe vëmendjes së tij. Gjatë kryerjes së detyrës zyrtare, polici duhet të ketë kujdes për respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut në të gjitha rrethanat dhe për çdo qytetar”.<sup>10</sup>

Njohja e punës nga ana e policit: Çdo profesion për të u ushtruar kërkon njohuri në atë lëmi. Ndërsa puna e policit kërkon përgatitje;

<sup>9</sup> Shishani, Fitim, Roli i policisë në parandalimin e kriminalitetit, Prishtinë, 2006. 40.

<sup>10</sup> Po aty, f. 41.

arsimim, shkathtësi, vetëmohim, sepse për veç cilësive të tjera të domosdoshme, polici nuk mund dhe nuk do të dijë të ushtroj funksionin e shenjtë që ka për detyrë nëse i mungojnë njohuritë rreth punës që i është besuar, me një fjalë puna e tij do të jetë jo kualitative.

“Bazuar në specifikat e këtij shërbimi, që konsistojnë në të drejtën për të ndërmarrë veprime ligjore që nuk i kanë qytetarët a organet tjera (legjitimimi, heqja e lirisë, paraburgimi, bastisja, përdorimi i mjeteve të dhunës, përdorimi i armës së zjarrit etj.), është e natyrshme që nga polici të kërkohet njohja në tërësi dhe e drejtë e të gjitha detyrave dhe autorizimeve ligjore”.<sup>11</sup>

Stërvitja e mirë praktike e policit: Konsideroj se puna policore nuk është punë komode për t’u kryer, përderisa nga policët kërkohet të jenë dinamikë d.m.th në lëvizje, të shpejtë për të vepruar, për t’u përballë me rezistenca të ndryshme, për gjitha këto për veç përgatitjes në lëmi të tjera, jetike është edhe përgatitja fizike.

Inteligjenca e policit: Një ndër karakteristikat e personalitetit të njeriut është edhe inteligjenca e tij. Si e tillë kjo karakteristikë duhet të jetë në nivel së paku mesatar për të shpresuar se një person mund t’i del në krye punës policore që do i besohej.

Përgjegjësia në punë dhe besnikëria e policit: Policia është organ i specializuar për parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit. Udhëheqja me parimin e ligjshmërisë është “kujdestari” më i mirë që ruan policin gjatë kryerjes së punës së tij për të mos ndërmarrë veprim kundërligjor. Në këtë drejtim polici duke u bazuar në parimin e ligjshmërisë bënë të kujdesshëm dhe përgjegjës për veprimet e tij, ky kujdes nënkupton veprimtarinë konform dispozitave ligjore, dhe njëkohësisht respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut.

“Përgjegjësia e policit ka të bëjë edhe me mosmarrjen e veprimeve ndaj veprave që mund të paraqesin shkelje të moralit shoqëror, mund të jenë të dëmshme për qytetarët dhe në kundërshtim me ligjin, siç janë p.sh. bixhozi, prostitucioni etj. Veprimet e tilla zbehin bashkëpunimin me qytetarët, humbin besimin ndaj tyre, dhe pa dyshim kjo është humbje për tërë këtë organ”.<sup>12</sup>

Pamja e jashtme e policit: Vetë qëllimi i krijimit të policisë, funksionimit të saj mbi bazën e misionit që i shërben shoqërisë për mirësi,

<sup>11</sup> Shishani, Fitim, Roli i policisë në parandalimin e kriminalitetit, Prishtinë, 2006, f. 42.

<sup>12</sup> Po aty. 46.

apriori kuptohet që njerëzit me këtë shërbim duhet qenë të dalluar për nga pamja me stil të veçantë dhe qëndrim pedant. Vetëm mirësjellja, shprehjet e pastra; qëndrimi dhe mënyra e komunikimit me stil të qytetëruar të policit me qytetarët dhe aftësia për të kuptuar detyrën me seriozitet bëjnë të mundshëm krijimin e imazhit të mirë të policit.

“Imazhi është një problem që nuk duhet nënvleftësuar. Psikologët argumentojnë se duhen më pak se 15 sekonda, që të tjerët të krijojnë përshtypjen rreth nesh, dhe ky impresion krijohet mbi bazën e asaj që ata e shohin dhe e dëgjojnë. Pamja e jashtme, uniforma dhe gjestikulacioni duhet të reflektojnë në çdo kohë statusin profesional”.<sup>13</sup>

Ndërsa, kriteret që duhet të posedojë policia, për të gëzuar epitetin e policisë demokratike, Dr. Bajram Yzeiri, përmend tri prej tyre<sup>14</sup>: përfaqësues, përgjegjës, të besueshëm.

Përfaqësues: Institucioni i Policisë duhet të jetë përfaqësues i komunitetit të cilit i shërben duke përfshirë dhe grupet apo pakicat kombëtare. Problemi shtrohet që të ketë kriteret të qarta ligjore për të siguruar pranimin e punonjësve të Policisë nga gjiri i shoqërisë, si dhe zbatohen procedura të ndershme rekrutimi sipas vlerave, pa bërë diskriminime për seksin, fenë, bindjet, krahinën, racën, etj.

Përgjegjës: Ky kriter ka të bëjë me përgjegjshmërinë, pra sa është e ndjeshme dhe përgjegjëse Policia për detyrat ndaj qytetarëve.

Të besueshëm: “Që policia të jetë e besueshme për veprimtarinë e saj, në radhë të parë duhet të përmbushë dy kriteret e para dhe së dyti të përqendrojë vëmendjen e saj për

të përmirësuar kulturën dhe sjelljen në shërbim, gatishmërinë për t’u përgjigjur me shpejtësi thirrjeve për ndihmë, shpejtësinë për zbulimin e krimit dhe arrestimin e autorëve, minimizimin e abuzimeve me detyrën dhe shfaqjen e korrupsionit, transparencën në trajtimin e problemeve etj.”<sup>15</sup>

Gjithsesi, se për veç këtyre besueshmëria ndaj policisë nga qytetarët, rritet apo zvogëlohet varësisht edhe kulturës që tregojnë policët në përditshmëri, si, p.sh.: të folurit, shprehjet, veprimet, etj.

<sup>13</sup> Kosta, Arqile, Etika e Policisë, Tiranë, 2004, f. 208.

<sup>14</sup> Yzeiri, Bajram, Manaxhimi i Policisë, Tiranë, 2003, f. 20.

<sup>15</sup> Yzeiri, Bajram, Manaxhimi i Policisë, Tiranë, 2003, f. 20-21.

#### 4. Shkaqet e krijimit të imazhit të keq për policinë

Organi i policisë është organ që është krijuar me qëllim të parandalimit dhe luftimit të dukurive devijuese dhe të dëmshme për shoqërinë. Andaj, duke u nisur nga kjo policia duhet të jetë shembull për shoqërinë civile se si duhet të sillet, respektuar, dhe kontribuar shoqërisë për të mirë. Se sa do të duket puna e policisë serioze dhe e pranueshme nga qytetarët, varet nga sjelljet e vetë këtij organi, prandaj respekti dhe mirëkuptimi fitohet reciprokisht. Policia pasqyron më së miri shtetin e caktuar, sepse ajo është organ që i përket administratës shtetërore, dhe që për herë, herë është në kontakt dhe në sy të shoqërisë. Prandaj, mendoj se çdo shtet dhe udhëheqje e këtij organi, duhet të ketë kujdes që policisë të i përkujtoj dhe tërheqë vërejtjen për distancimin nga sjelljet devijuese dhe të ndaluara, që do bëheshin shkaqe për krijimin e imazhit të keq për të.<sup>16</sup>

Para se të flas për disa nga shprehjet apo sjelljet që krijojnë imazh të keq për policinë, do paraqes disa nga veprimet, shprehjet dhe mos kryerja e detyrës sipas detyrave apo tejkalimit të autorizimeve që ligji për policinë e Republikës së Kosovës i emërton si shkelje disiplinore. Me qëllim që ky punim të jetë sa më praktik në vijim do paraqesim llojet e shkeljeve disiplinore.

##### - Shkeljet e rënda disiplinore

Zyrtarët policorë dhe stafi civil bëjnë shkelje të rëndë disiplinore nëse ai/ajo kryen, tenton të kryejë, ndihmon ose nxit tjetrin ta kryejë njërën nga veprimet e mëposhtme: sjellja e rëndë diskredituese; mosbindja e rëndë; zbulimi i pavend dhe i rëndë i informatave; korrupsioni; shkelja e rëndë e autorizimit; përdorimi i pavend i armës; përdorimi i tepërt i forcës; dëmtimi i rëndë i pasurisë së Policisë; përdorimi i alkoolit ose i substancave të tjera intoksikuese; ngacmimi seksual gjatë shërbimit; veprimet diskriminuese në bazë të moshës, gjinisë, orientimit seksual si dhe përkatësisë etnike dhe fetare; keqpërdorimi dhe shfrytëzimi seksual i ndonjë personi; veprimtaria penale.<sup>17</sup>

##### - Shkeljet e lehta disiplinore

Zyrtarët policorë dhe stafi civil bëjnë shkelje të lehtë disiplinore nëse ai/ajo kryen, tenton të kryejë, ndihmon ose nxit tjetrin ta kryejë

<sup>16</sup> Halimi, Armend, Roli i policisë në luftimin e kriminalitetit në Kosovë, Prishtinë, 2015, f.97.

<sup>17</sup> Ligji për Policinë e Republikës së Kosovës, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", Prishtinë, 2008, nenet 46, 47.



njërën nga veprimet e mëposhtme: sjellja e lehtë diskredituese; mosbindja e lehtë; pakujdesia në detyrë; zbulimi i pavend dhe i lehtë i informatave; keqpërdorimi i lehtë i autorizimit; dhe dëmtimi i lehtë i pasurisë së Policisë ose mbajtja e papërshtatshme e uniformës dhe paraqitja e papërshtatshme personale. Sjelljet apo shprehjet e tjera që i konsiderojnë si shkaqe për krijimin e imazhit të keq për policinë, dhe me qëllim që të shihet se kur e si kryhen ato do të i shpreh tani;

- Shprehjet e pahijshme nënkuptojnë, fjalë të pista dhe fyese, që bien në kundërshtim me fjalorin moral dhe intelektual, e me një fjalë pasqyrojnë gjuhë vulgare. Literatura profesionale përmend një klasifikim të fjalëve që në rast shprehen nga polici zyrtar konsiderohen fjalë të shprehjeve të pahijshme;<sup>18</sup>

- Fjalë që kanë ngjyrimet fetare (p.sh. djall, vafsh në djall, të martë djalli, etj.)

- Fjalë që tregojnë funksione jashtëqitëse (p.sh. më ha..., shko ore..., ik ore bë...)

- Fjalë që janë të lidhura me funksione seksuale (p.sh. të q..., bir i bushtrës, etj.)

Përveç këtyre, edhe gjestet apo sjelljet e këqija e tjera të policisë me qytetarët janë shkaqe që krijojnë imazh të keq për policinë. Marrim shembull një fakt në policinë kosovare, ku nuk janë të rralla rastet që ankohen qytetarët për shprehje jo adekuate të policisë në rast ndalje, p.sh shprehi e keqe e këtyre të fundit ka qenë dhe vazhdon akoma të jetë, kur me rastin e ndaljes së automjeteve të qytetarëve, policët në vend të përshëndetjes dhe arsytimit të ndaljes, përdorin fjalët “ku ishit?”, “ku po shkoni?”.

Sjelljet devijuese kryhen nga policët gjithherë kur ata nuk respektojnë normat morale dhe ligjore të shoqërisë, duke i dhunuar ato. Në këto raste, polici edhe pse është ai që duhet të parandalojë dhe luftojë sjelljet devijuese, pikërisht ai shndërrohet në person që ndër merr veprime të pamoralshme dhe kundërligjore siç mund të jenë: shoqërimi me persona problematik, shmangja nda detyra dhe përgjegjësia etj. “Policia, si një institucion i shtetit, i krijuar për të kontrolluar krimin, ka ndonjëherë punonjës, që në vend ta luftojnë

krimin, kryejnë edhe vetë shkelje të rënda të ligjit penal ose përfshihen në veprimtari kriminale.”<sup>19</sup>

<sup>18</sup> Yzeiri, Bajram, Manaxhimi i Policisë, Tiranë, 2003, f. 20.

<sup>19</sup> Kosta, Arqile, Etika e Policisë, Tiranë, 2004, f. 230.

- Abuzimi me alkoolin dhe substancat narkotike kryhet kur policët abuzojnë me këto dy produkte, që në fakte veprimet e tilla janë të ndaluara për gjithë shoqërinë. Aq më tepër janë të ndaluara për policët kur ata janë të ngarkuar me detyrë që të parandalojnë dhe luftojnë përdorimin, prodhimin, dhe shitjen e paautorizuar të alkoolit dhe substancave narkotike. Kur policët përdorin alkoolin dhe substancat narkotike gjatë detyrës, përveç tjerash konsiderohen se kryejnë shkelje të rëndë të rregullave të disiplinës së policisë, me ç'rast pasojnë masat disiplinore të rënda apo edhe shkarkim nga detyra.

- Diskriminimi nënkupton qëndrime apo veprime të diferencuara të policisë ndaj qytetarëve, shkak që këta të fundit i përkasin aspektit social, politik, religjioz, etnik, racor tjetër. Disa nga rastet e kur polici kryen diskriminimin janë: ndalimi i panevojshëm i njërës qytetarë e lëshimi ndaj tjetrit për arsye se ata dallojnë për nga përkatësit e lart-cekura, pastaj mos reagimi i policit ndaj nevojës së një qytetari për arsye se ai mund të i përket një përkatësie tjetër.

- Brutaliteti nënkupton përdorimin e forcës së tepruar apo autorizimeve tjera që i

janë dhënë policisë për kryerjen e funksioneve ashtu siç kërkon ligji dhe shoqëria demokratike. Andaj, thënë më thuktë me brutalitet duhet nënkuptuar përdorimin e panevojshëm të forcës nga policët. "Forca mund të mendohet si një kontinuum i segmenteve që fillojnë nga përdorimi i kërcënimit e deri në përdorimin e forcës vdekjeprurëse duke qëlluar me armë një të dyshuar".<sup>20</sup>

- Tortura dhe trajtimi poshtëruës dhe çnjerëzor, me torturë nënkuptojmë aktet të dhunës që i ushtron policia ndaj një të dyshuari. Tortura mund të jetë fizike dhe psikike.

Aktet torturuese fizike mund të jenë: rrahjet, therjet, përdorimi i mjeteve elektrike që shkakton shok, futja e kokës në uji, privimi nga të ushqyerit dhe uji për kohë të gjatë, ekspozimi në temperature të ulëta apo shumë të larta, lënia në errësirë të plotë, etj.

Ndërsa, aktet torturuese psikike mund të jenë: kërcënimi, frikësimi, mohimi për pushim, lënia në mes mijave me qëllim të futjes së frikës etj. Këto akte torturuese gjithë herë bëhen me qëllim të nxjerrjes së informatave apo deklaratës nga i dyshuari apo i akuzuari pa dëshirën e tij.<sup>21</sup>

<sup>20</sup> Kosta, Arqile, Etika e Policisë, Tiranë, 2004, f. 232.

<sup>21</sup> Halimi, Armend, Roli i policisë në luftimin e kriminalitetit në Kosovë, Prishtinë, 2015, f.101.

Ndërsa, për dallim nga tortura aktet poshtëruese dhe trajtimi çnjerëzorë bëhet jo me qëllim të nxjerrjes së informatave por hakmarrjes. Që të dyja këto akte si me konventa ndërkombëtare si me legjislacion vendor janë rreptësisht të ndaluara dhe nuk lejohen në as një situatë, si të tilla në rast se i aplikon policia paraqesin ndër shkaqet kryesore për krijimin e imazhit të keq për policinë.

- Korrupsioni: Sipas psikologut shqiptar Leonard Prifti: “Zemra e çdo njeriu është tepër lakmitare në kërkesat ndaj jetës. Ajo mashtron që nga ata që quhen rrugaç e deri tek ata që janë filozofë, shkencëtarë, burra shteti apo edhe klerik”.

Me korrupsion nënkuptojmë keqpërdorim të pozitës zyrtare për qëllime të përfitimit. Andaj, nisur nga kjo, konsideroj se këtë formë të kriminit mund ta kryejë vetëm personi zyrtar, kuptohet duke u mundësuar nga personi që e mundëson këtë e ky i fundit mund të jetë dhe është në shumicën e rasteve person nga shoqëria civile. Korrupsioni varësisht nga zyrtari i organit shtetëror që kryhet, në aspektin teorik klasifikohet në forma të ndryshme. Kështu, korrupsioni i zyrtarit policor, ka të bëjë me korrupsion administrativ, ngase policia i përket administratës shtetërore të uniformuar. Polici kryen aktin korruptiv kur duke shfrytëzuar kompetencat dhe autorizimet e veta merr mito me qëllime përfitimi për vete ose për tjetrin, p.sh. duke bërë lëshime ndaj personave që kanë kryer kundërvajtje, duke fsheh provat për personat e dyshimtë si kryes të krimeve, duke ndihmuar dhe mundësuar kontrabandën dhe trafikimet e ndryshme etj.

### **5. Përdorimi i forcës dhe armës së zjarrit nga policia, standardet dhe përgjegjësitë**

Për kryerjen e detyrave apo funksioneve që e autorizon ligji, policia ka të drejtë të përdorë forcën aq sa ajo të mos shihet si kundërligjore. Lufta kundër kriminalitetit nuk mund të paramendohet pa forcë e jo rrallë herë edhe pa armë zjarri.

Forca në punët policore, nuk duhet nënkuptuar vetëm si përdorim të dhunës fizike, ajo në një mënyrë shihet si e tillë nga vetë prezenca e policit karshi qytetarëve.

Pastaj, mënyra e prezantimit dhe zhvillimit të bisedës që në rast të ngritjes së tonit të zërit dhe shprehjes së fjalëve kërcënuese kalon në një lloj dhune psikike.

Mirëpo, duhet gjykuar logjikshëm se kur ngritja e tonit të zërit dhe prezantimi i forcës nga policia bëhet me qëllim të tërheqjes së

vërejtjes së personit apo personave për t'i parandaluar nga veprimet e dëmshme, konsideroj se akti i tillë është i pranueshëm dhe i dobishëm.

Nga sa u tha, duhet kuptuar dallimin mes forcës dhe dhunës, ku siç u paraqit, forca kuptohet vetë prezenca e policit, mjetet policore: sprej lotsjellës, prangat, shufrat e gomës, arma e zjarrit, ndërsa kalojnë këto në dhunë me praktikumin e tyre. Mirëpo, edhe kur ajo kalon në dhunë apo siç ndihet ndryshe shtrëngim ligjor me qëllim të realizimit të detyrave që janë të obliguar si në parandalimin dhe luftimin e dukurive negative e kriminale, zgjidhjen e konflikteve dhe mbrojtjen e rendit, gjithherë duhet konsideruar të ligjshëm. Duhet thënë se, forca apo arma e zjarrit të cilën zotërojnë policët, të cilën ua njeh ligji si autorizim, nuk duhet keqkuptohet si një të drejtë që të lëndojë ose dëmtojë apo edhe të vrasë, por si mjet që mund të jetë i domosdoshëm për kryerjen e funksioneve në të mirë të shoqërisë. Në të kundërtën, konsideroj se mosshfrytëzimi i kësaj të drejte nga punonjësit e policisë kur është e nevojshme për mbrojtjen e jetës, shmangien e rrezikut dhe mbrojtjen e rendit dhe qetësisë publike, kemi të bëjmë me shmangieje nga detyra zyrtare, thënë ndryshe neglizhencë policore.

“Asgjë nuk mund të shkatërrojë më rrënjësisht besimin tek policia se sa polici i përgatitur keq, që nuk arrin të mbrojë qytetarin nga një akt kriminal i rrezikshëm për jetën apo në mbrojtje të dinjitetit qytetar”.<sup>22</sup>

Pra, nga kjo del se, për veç kujdesit që duhet tregoj polici në rast të përdorimit të armës, megjithatë, do të ishte paaftësi e tij, apo neglizhencë në detyrë, sikur në një rast të jenë shterur të gjitha mundësit e përdorimit të masave më të lehta, e që logjikshëm paraqet nevojën e përdorimit të armës së zjarrit, ndërsa polic nuk e përdorë.

Forca sipas ligjit për policinë e Kosovës nënkupton: forcën fizike, shufrën zyrtare, spreji, mjetet pranguese, mjetet për ndalimin e automjeteve, qenin e policisë, mjetet kimike për paftësim të përkohshëm, kalin e policisë, armët e zjarrit, topat e ujit, automjetet dhe llojet e veçanta të armëve dhe mjeteve shpërthyes.<sup>23</sup>

Forca të cilën posedon policia, për t'u konsideruar e drejtë në rast të përdorimit të saj, ajo gjithherë duhet të filloj dhe përfundojë me arsye.

“Punonjësit e policisë vazhdimisht janë të detyruar t'i përgjigjen pikëpyetjes: në çfarë mase duhet ta përdorin diskrecionin e tyre për të

<sup>22</sup> Haziri, Fatos, E drejta e Policisë, Prishtinë, 2010, f. 96.

<sup>23</sup> Ligji për Policinë e Republikës së Kosovës, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, Prishtinë, 2008, neni 25, paragrafi 5.

vendosur të injorojnë një shkelje ordinere të ligjit, të qortojnë ose gjobitin, të ndalojnë, arrestojnë apo të qëllonjë dikë duke mbetur brenda kërkesave të ligjit<sup>24</sup>

Si e tillë, mendoj se përdorimi i saj duhet nisur në çdo rast që nga ato me të lehtë për të kaluar tek më e rënda, vetëm kur forca paraprake nuk është e mjaftueshme mbi parimin e proporcionalitetit dhe oportunitetit. Thënë më ndryshe, kjo forcë duhet përdorur vetëm atëherë kur është e domosdoshme, dhe vetëm deri në atë nivel që kërkohet për t'i arritur objektivat legjitime, duke u zbatuar me maturi dhe zgjidh llojin e forcës më të përshtatshme, duke minimizuar atë për të minimizuar edhe pasojnë që do të shkaktohet nga ajo.

Forca policore e përdorur në raste të caktuara për t'u parë në korniza të normales, duhet të përfshinë ato veprime shtrënguese, që policët i shohin të arsyeshme mbi bazën e përvojave të tyre të suksesit të arritur në raste të veçanta, si të domosdoshme, të përshtatshme. Edhe pse nuk mirëpritet, megjithatë forca normale është reagim i domosdoshëm dhe i natyrshëm i policit ndaj kërkesave urgjente që paraqesin situatat e caktuara.

Pra, jo rrallëherë, përkundër dëshirës së policit që të përdorë armën, nevoja urgjente, siç mund të jetë: shpëtimi jetës së qytetarit apo vetes, kolegut, etj., si dhe raste të tjera, kërkon doemos përdorimin e saj.

LPK (ligji për Policinë e Kosovës), shprehimisht përcakton rastet se në cilat rrethana policia mund të përdorë forcën, si për ta mbrojtur jetën e personit, për ta parandaluar sulmin, kryerjen e veprës penale, arratisjen e kryesit të veprës penale, arratisjen e kryesit të veprës apo atëherë kur masat e tjera nuk janë të suksesshëm për arritjen e një objekti të ligjshëm të Policisë.<sup>25</sup>

E drejta e përdorimit të armës së zjarrit nga policia, paraqet problem në vetvete gjë që kërkon qasje të veçantë. Pa dashur që t'i jap të drejtë ndonjë forme apo mjeti tjetër të forcës nga policia, konsideroj se kujdes i veçantë duhet kushtuar përdorimit të armës së zjarrit. Ngase, për dallim nga gabimet e tjera që mund të bëhen, gabimi me armë të zjarrit nuk falet, sepse pasoja nga ajo është e papërmirësueshme. Në këtë drejtim, përveç të drejtës të përdorimit të forcës apo armës së

<sup>24</sup> Kosta, Arqile, Etika e Policisë, Tiranë, 2004, f. 326.

<sup>25</sup> Ligji për Policinë e Republikës së Kosovës, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", Prishtinë, 2008, neni 25, paragrafi 2.

zjarrit, duhet njohur edhe rastet kur ajo lejohet të përdoret, kufizimet dhe standardet e përdorimit dhe përgjegjësia në rast të keqpërdorimit.

Sipas dispozitës së nenit 26, paragrafi 2 të Ligjit për Policinë e Kosovës, shprehimisht paraqet rastet kur mund të përdoret arma e zjarrit; zyrtari policor është i autorizuar ta përdorë armën e zjarrit kundër personit tjetër vetëm kur mjetet më pak ekstreme janë të pamjaftueshme që ta:

a) mbrojë jetën e vet ose jetën e të tjerëve nga sulmet e pashmangshme;

b) parandalojë kryerjen e pashmangshme apo vazhdimësinë e veprës penale që shkakton rrezik të lartë për jetën;

c) arrestojë personin i cili paraqet rrezik për jetën e të tjerëve dhe që u reziston urdhrave ligjorë të dhënë nga zyrtari policor; dhe

ç) parandalojë arratisjen e personit i cili paraqet rrezik të pashmangshëm për jetën e personave të tjerë dhe që u reziston urdhrave ligjorë të dhënë nga zyrtari policor.<sup>26</sup>

Janë disa rrethana pa të cilat përdorimi i armës së zjarrit nga policia do të konsiderohet i kundërligjshëm. Fjala është për mbrojtjen e nevojshme, e cila njëherësh nga drejtësia konsiderohet si rrethanë që përjashton përgjegjësinë penale. E që për të ekzistuar mbrojtja e nevojshme, paraprakisht duhet të ekzistojnë sulmi dhe rreziku. Ndërsa, sulmi duhet të jetë i kundërligjshëm dhe i rrezikshëm.

Sulmi duhet të jetë flagrant dhe i atypëratyshëm, pra rreziku të jetë i pranishëm d.m.th të ketë filluar dhe të mos ketë mbaruar.

Duhet theksuar se, mbrojtja e nevojshme e policisë duhet të bëhet në rastet kur mbrohen si vetë policët sikurse ndonjë person. Është me rëndësi të thuhet se, mbrojtja lejohet vetëm kundër një sulmi që shihet se po përgatitet dhe i atëçastshëm, pra jo edhe kundër përgatitjes së një sulmi që dyshohet se mund të bëhet në të ardhmen, pasi sulmi nuk është i sigurt se mund të realizohet. Në rast të mbrojtjes së nevojshme të bërë nga policia me anë të përdorimit të armës së zjarrit, duhet të bëhet vetëm kundër personave që marrin pjesë direkt në sulm, pra, jo edhe kundër personave që gjenden me sulmuesin, të cilët nuk paraqesin rrezik.<sup>27</sup>

<sup>26</sup> Ligji për Policinë e Kosovës, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, Prishtinë, 2008, neni 26, paragrafi 2.

<sup>27</sup> Halimi, Armë, Roli i policisë në luftimin e kriminalitetit në Kosovë, Prishtinë, 2015, f.106.

Fakt tjetër me rëndësi është edhe ajo se mbrojtja duhet të jetë në proporcion me sulmin, që do të thotë, mjetet që përdor për mbrojtje policia, duhet të jenë të domosdoshme apo të nevojshme. Përveç kësaj, gjatë mbrojtjes duhet ketë kujdes në mos kapërcimin e kufijve të mbrojtjes, sepse atë herë nuk do konsiderohet vetëmbrojtje.

Përveç këtyre, si kushte për të drejtën e ushtrimit të mbrojtjes së nevojshme nga policia, e në rast se bëhet me armë zjarri si standard duhet të jetë edhe paralajmërimi për përdorim të saj. Është absolutisht e logjikshme e po kështu humane, që para përdorimit të armës së zjarrit nga policia, personit ndaj të cilit do të përdoret, duhet t'i bëhet me dije se çfarë do të pësojë, ngase është jonjerëzore të vrasësh një njeri, pa i dhënë atij mundësinë të dorëzohet.

Sipas dispozitës së nenit 26, paragrafi 3 të Ligjit për Policinë e Kosovës, theksohet se;

Para se të përdor armën e zjarrit, zyrtari policor jep vërejtje gojore, prezanton veten si zyrtar policor, duke urdhëruar personin që të ndalet, por edhe duke e paralajmëruar se do të shtie nëse ai/ajo nuk ndalet.<sup>28</sup>

Përrjashtimisht, si masë e veçantë në rrethana urgjente, zyrtari policor mund të mos e bëjë paralajmërimin, në rast se një veprim i tillë e rrezikon zyrtarin policor, ose personat e tjerë, nga një rrezik serioz i pashmangshëm.<sup>29</sup>

Po ashtu, ekzistojnë disa kufizime në përdorimin e armëve të zjarrit nga policia. Kufizimet e tilla kanë të bëjnë kryesisht me dy situata;

- Kundër personave që i përkasin tri kategorive si fëmijë, gra dhe pleq. Kufizimet lidhur me përdorimin e armës së zjarrit nga policia ndaj këtyre kategorive gjatë mbrojtjes së nevojshme, më tepër duhet kuptuar si kujdes, sepse mbrojtja e nevojshme si një ndër shkaqet që përjashton përgjegjësinë penale, lejohet ndaj çdo personi pa përjashtim, mjaftojnë që sulmi të jetë i rrezikshëm për jetën.

- Kufizimet e përdorimit të armës së zjarrit në vende publike, sidomos në situata kur arma e zjarrit paraqitet si nevojë për përdorimin, duhet përpjekur deri në maksimum për evitimin e përdorimit të saj, ngase në vendet publike ku ka grumbull njerëzish, përveç fajtorit aksidentalisht mund të qëllohen edhe persona të tjerë të pafajshëm.

<sup>28</sup> Ligji për Policinë e Kosovës, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", Prishtinë, 2008, neni 26, paragrafi 3.

<sup>29</sup> Ligji për Policinë e Kosovës, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", Prishtinë, 2008, neni 26, paragrafi 4.

Edhe pse arma zyrtare e policisë është si mjet i autorizuar për të i shërbyer vetëm të mirës, ajo në kuptimin e përgjithshëm është mjet i dëmshëm i cili ka fuqinë të lëndoj apo edhe vrasë, ngase si mjet vepron dhe orientohet varësisht veprimit dhe dëshirës së poseduesit, pa pasur mundësin të përshkojë rrugën e duhur për të evituar aksidentet.

Vlerësimi individual i policit rreth përdorimit apo mospërdorimit të armës së zjarrit mendoj se duhet të bëhet me kujdes. Ngase, ai pas përdorimit duhet të jap arsyen pse vendos të përdorë armën e zjarrit. Edhe atëherë kur përdorimi i armës së zjarrit bëhet me anë të urdhrit të eprorit, polici duhet të di se është urdhër i drejtë ose jo, ngase, urdhri nuk e përjashton nga përgjegjësia penale policin, i cili gjatë përdorimit të armës së zjarrit kryen veprim të kundërligjshëm.

Si përfundim rreth kësaj qasje, konstatoj se përgjegjësia është element që duhet të i përgjigjet edhe policia për veprimet e tyre të kundërligjshme. Madje, konsideroj se ky organ ka përgjegjësi të dyfishtë, sepse për dallim nga qytetarët policët janë persona të cilët pikërisht janë ata që duhet të parandalojnë dhe luftojnë të keqen.

### **Conclusions**

As the result of all this was said in this paper, what was presented and noted, we conclude that the mission and vision of police in a democratic state must be entirely to the benefit of society, being at the same time according to the law. While looking at the functions of the police, that means its powers, we consider that the role of this institution is irreplaceable, because the police is serving for the good of the country and society, such as respecting and protecting the fundamental human rights and freedoms, protection of public safety and security, the rule of law, prevention and combating crimes and its detection, etc. On the other hand, looked to the functions or saint mission of police, it appears logical to demand that this institution has a commitment to establish authentic values, not only professional, but also ethical values towards the citizens, so that as the body is acceptable and respectful society. Obviously we concluded that for all this to be possible, the members of this important body previously should avoid expressions, gestures, and other actions that seem as anomalous that must look as the contrast between their personalities and mission that they have. Part of this work is the use of force and firearms, and from what we exposed here, we can conclude that the use of force and firearms, while seen as legal authorization, should be seen as a need to fulfill the challenging mission



that police have. However, a thing to be seen as an right authorization, we found out that police should be careful in the use of this force, only on the basis of the absolute necessity and the level proportional faced with the challenge, and being responsible before the law in overcoming this authorization or breach of professional standards.

### **Literatura**

#### **Libra dhe publikime të shfrytëzuara dhe të cituara**

George M. Pugh, *The Good Police Officer, Roles, and Concepts*, Izbor članka iz stranih časopisa, Zagreb, 1987.

Halimi, Armend, *Roli i policisë në luftimin e kriminalitetit në Kosovë*, Prishtinë, 2015.

Haziri, Fatos, *E drejta e Policisë*, Prishtinë, 2010.

Latifi, Vesel, *Taktika kriminalistike*, Prishtinë, 2001.

Latifi, Vesel, *Kriminalistika*, Prishtinë, 2011.

Sahiti, Ejup, *E drejta e Procedurës Penale*, Prishtinë, 2005.

Shishani, Fitim, *Roli i policisë në parandalimin e kriminalitetit*, Prishtinë, 2006.

Kosta, Arqile, *Etika e Policisë*, Tiranë, 2004.

Yzeiri, Bajram, *Manaxhimi i Policisë*, Tiranë.

Ligji për Policinë e Republikës së Kosovës, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, Prishtinë, 2008.